

Informatë mbi realizimin e projektit të rehabilitimit gjeneral të fazës së I dhe II të linjës së 10-të hekurudhore

Njëri ndër projektet më voluminoze i një rëndësie të veçantë për sistemin hekurudhor të Kosovës është rehabilitimi gjeneral dhe modernizimi i linjës së 10-të hekurudhore e cila e lidhë Kosovën me Serbinë në veri dhe Maqedoninë e Veriut në jug.

Në takimin e rregullt të Bordit të Drejtorëve të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS datë 28.03.2022, kryesuesi së bashku me anëtarët e tjerë të bordit kanë kërkuar që të mbahet një takim informues me: Njësinë për implementimin e projektit PIU, Kompaninë mbikëqyrëse të realizimit të projektit HILL International dhe Kompaninë punëkryese Generale Costruzioni Ferroviarie (GCF).

Në mënyrë që të informohet në detaje për zhvillimet e këtij projekti, respektivisht të rehabilitimit gjeneral të fazës së parë të linjës së 10-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut), Bordi i Drejtorëve i Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, me datën 06.04.2022 ka mbajtur një takim pune me të gjitha palët e interesit përfshirë këtu:

- Njësinë për implementimin e projektit (PIU) e cila është pjesë e INFRAKOS-it;
- Kompaninë mbikëqyrëse të realizimit të projektit HILL International; dhe
- Kompaninë punëkryese Generale Costruzioni Ferroviarie (GCF).

Përveç Bordit të Drejtorëve dhe menaxhmentit të INFRAKOS-it, në këtë takim ishte i pranishëm edhe Këshilltari i Ministrisë të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. Edison Mavraj që të informohet nga dora e parë mbi zhvillimet e këtij projekti.

Paraprakisht ishte kërkuar që për shkak të informimit më të mirë dhe më të drejtë, takimi të mbahet veç e veç me të gjitha palët e sipërpërmendura, prej të cilave ishte kërkuar që përmes prezantimeve të tyre të paraqesin gjendjen aktuale të këtij projekti me të gjitha zhvillimet e deritanishme, përfshirë këtu edhe problemet dhe sfidat për realizimin e këtij projekti sipas afateve të përcaktuara.

Takimi i parë u mbajt me PIU-në dhe takimin e hapi Kryesuesi i BD-së z. Afrim Mehmetaj i cili kërkoj nga Udhëheqësi i PIU-së që të bëjë prezantimin e gjendjes aktuale të këtij projekti duke kërkuar në mënyrë specifike që të potencohet progresi i punëve, problemet aktuale dhe opinionin profesional të PIU se a ka mundësi që projekti të kryhet në afatin e paraparë, si dhe cilësia e punëve të jetë në nivelin më të lartë të mundshëm duke i plotësuar kështu standardet e interoperabilitetit.


PIU e bëri prezantimin e gjendjes aktuale të projektit duke prezantuar detajet teknike të këtij projekti siç janë: gjatësia e binarëve primarë dhe sekondarë, numri dhe lloji i urave, lëshesave, tuneleve, platformave, mureve mbajtëse, vendkalimeve në nivel, stacioneve, vendndalimeve, etj. si dhe duke potencuar se deri më tani janë realizuar rreth 25.3 % e punëve.



Pyetjeve të BD-së dhe menaxhmentit, në veçanti lidhur me realizimin e projektit në kohën e paraparë (32.12.2022) i dha përgjigje PIU-ja duke potencuar se ata janë të angazhuar dhe do të angazhohen maksimalisht që ky projekt të kryhet në afatin e paraparë dhe se nga ana e tyre do të bëhet e pamundura që të realizohet me sukses projekti në fjalë.

Kërkesa e BD-së ishte që PIU-ja duhet të ketë angazhim më të madh dhe t'i kryejë me përgjegjësinë më të lartë detyrat e veta ashtu që projekti të kryhet me cilësi dhe brenda afatit të dakorduar ndërmjet palëve.

Takimi i dytë i radhës ishte me kompaninë mbikëqyrëse të projektit HILL International e cila përmes prezantimit të saj sqaroi në detaje të gjitha problemet dhe zhvillimet e këtij projekti që nga fillimi e deri në ditët aktuale. Përfaqësuesi i HILL-it përmes prezantimit pasqyroj të dhënat kryesore të këtij projekti dhe atë:



HILL informoj BD-në se si kompani mbikëqyrëse ka bërë dhe bënë maksimumin për mbrojtjen e interesave të INFRAKOS-it dhe se sipas mendimit të tyre punëkryesi do ta shfrytëzojë çdo mundësi për vazhdimin e afatit të kryerjes së punëve.

Bordi e falënderoj HILL-in për punën e bërë duke kërkuar që kjo kompani të vazhdojë me përgjegjësinë më të lartë punën e saj në realizimin e suksesshëm të këtij projekti dhe se mbështetja e BD-së dhe menaxhmentit nuk do të mungojë.

Bordi drejtuës ngriti shqetësimet të HILL International lidhur me vonesat në kryerjen e punëve nga ana e punëkryerit siq janë vonesat në riparimin e urave, tuneleve si dhe ato në linjë të hapur, gjithmonë bazuar në raportin e prezantuar nga HILL. Kryesuesi i bordit kërkoj nga HILL International që të bëhet presion pozitiv të punëkryerit (GCF) me qëllim që infrastruktura e paraparë të kryhet ashtu siq e parasheh aneksi kontrata pra deri me 31 Dhjetor 2022.



Takimi i tretë i BD-së u mbajt me kompaninë përkryerës GCF e cila përmes prezantimit të saj shpjegoi në detaje realizimin e të gjitha punëve deri më tani sa i përket demontimit të binarëve të vjetër, shtrimit të shtresës së poshtme të binarëve, ndërtimin e binarëve të rinj primarë dhe sekondarë, urave, lëshesave, platformave, të stacioneve, vendndalesave, mureve mbrojtëse, etj.

Fokusimi i GCF-së ishte në problemet rreth kohës së pandemisë, projekt dizajnit të tuneleve dhe disa çështjeve tjera që sipas tyre kanë ndikuar që projekti të mos kryhet në kohën e paraparë më herët.



Qëndrimi i BD-së ishte shumë i qartë në raport me punëkryerësin, duke kërkuar që kjo kompani ta përfundojë projektin në kohën e paraparë (31.12.2022), duke premtuar që INFRAKOS-i do të bëjë gjithçka të jetë e mundur për mbështetjen e kësaj kompanie për realizimin me kohë të projektit. Pas kërkesës së BD-së që GCF të deklarohet për atë se a do ta përfundojë GCF-ja projektin në kohën e paraparë, menaxheri i GCF-së z. Roberto Accinelli u zotua se GCF-ja do ta përfundojë projektin me datën 31.12.2022, ashtu siç edhe është paraparë me aneks kontratë.

Informatë mbi fazën e dytë të linjës së 10-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë)

Një çështje tjetër e diskutuar me GCF-në kishte të bëjë edhe me fillimin e punëve për rehabilitimin gjeneral dhe modernizimin e fazës së dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë), pasi që kjo kompani është kontraktuar nga INFRAKOS-i për realizimin e punëve edhe për këtë fazë.

Kërkesa e GCF-së ishte që të paguhet avansi i paraparë me kontratë në mënyrë që kjo kompani të mund të fillon punët për rehabilitimin gjeneral dhe modernizimin e fazës së dytë. Problemi i pagesës së avansit ndërlikohet me tri kërkesat e BERZH-it të cilat janë përcaktuar me marrëveshjen e vitit 2015 dhe kanë të bëjnë me:

1. Zbatimin e Planit për Menaxhimin e Aseteve dhe Pagesave të Qasjes në Binarë
2. Trajnimin e stafit për zbatimin e standardeve të raportimit financiar ndërkombëtar (IFRS); dhe
3. Auditimin e PF. nga një kompani e pranuar dhe e licencuar nga BERZH-i.

Për pikën e parë INFRAKOS-i nuk i ka pasur dhe nuk i ka mjetet financiare për blerjen e softuerit, andaj BERZH-i kërkon një zotim nga Qeveria që do ta mbështes këtë projekt. Lidhur me këtë çështje u kërkua nga këshilltari i ministrit që të prezantojë këtë kërkesë në ministri dhe përmes një letre shpjeguese për BERZH-in ministria të zotohet për zbatimin e këtij projekti.

Për pikën e dytë pas shumë diskutimeve e ka marrë për obligim që trajnimin për implementimin e IFRS-së ta bëjë BERZH-i.

Pika e tretë për auditimin e pasqyrave financiare duhet realizuar nga INFRAKOS-i pasi që për vitin 2020 kishte angazhuar një kompani audituese e licencuar nga BERZH-i dhe e njëjta do ta bënë auditimin edhe për vitin 2021.